

Raporti Vjetor 2015

Instituti i Sigurimeve, Insig sh.a.



INSIG
i madh dhe i sigurt

RAPORTI VJETOR

2015





www.insig.com.al



Shqipëri

Rruga "Kavajës", Nr. 116,
Tiranë ALBANIA
Tel : +355 04 2234170
Fax : +355 04 2223838
E-mail: info@insig.com.al

Kosovë

"Rruga Pashko Vasa",
nr,4, Prishtinë
Tel.: +381 38 549 904
Fax: +381 38 549 904

Maqedoni

Ul. "Dame Gruev", nr.5-8/8,
Shkup
Tel.: +389 2321 5515
Fax.: +389 2321 5515

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit të Përgjithshme	6
Zhvillimet ekonomike në vend	8
Tregu i sigurimeve	9
Paraqitja e INSIG	9
Pronësia mbi kompaninë	10
Organigrama e Insig sh.a.	12
Aktiviteti sigures	13
Dëmet nga Veprimtaria siguruese	17
Pasqyra e pozicionit financiar	18
Shenim mbi pasqyrat financiare	20
Raport (Permbledhje)	24

FJALA E DREJTORIT TË PERGJITHSHEM

*I nderuar zoti Ministër,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës!*

Zonja dhe Zotërinj,

Programi financiar dhe objektivat e veprimtarisë së INSIG sh.a. për vitin ushtrimor 2015 kanë synuar ndalimin e rënies së vazhdueshme të pozicionit të shoqërisë në tregun e sigurimeve dhe të problematikave të tjera komplekse të trashëguara nga administrimi i mëparshëm i saj. Kjo është arritur nëpërmjet rishikimit, stabilizimit dhe konsolidimit, sipas kërkesave të ligjit dhe standardeve përkatëse, të të gjithë treguesve ekonomikë e financiarë lidhur me asetet, të ardhurat dhe shpenzimet, si edhe të profesionalizmit dhe integritetit të kapaciteteve njerëzore në praktikat e punës së shoqërisë dhe në shërbimet e ofruara ndaj klientëve.

Treguesit ekonomikë e financiarë dhe të dhënat e tjera që rezultojnë në përfundim të vitit ushtrimor 2015, dëshmojnë se, në tërësi, INSIG sh.a. ka mundur të përmbushë një pjesë të mirë të detyrave dhe objektivave të vendosura nga programi financiar dhe i veprimtarisë së shoqërisë. Është vendi për të evidentuar që për arritjen e këtyre rezultateve kanë kontribuar me punën dhe angazhimin e tyre drejtuesit dhe punonjësit e grupit INSIG në tregjet e të tre territoreve ku shoqëria jonë është e pranishme, në Maqedoni, Kosovë, dhe në mënyrë të veçantë INSIG sh.a. që operon në tregun shqiptar të sigurimeve.

Kështu, për herë të parë, jo vetëm që u ndal fenomeni i rënies dhe përkeqësimit të vazhdueshëm të pozitës në treg të INSIG sh.a. Shqipëri, por edhe u arrit që kjo shoqëri, në pjesën më të madhe të fushave të sigurimit, të përmirësojë pozicionin në treg, duke rritur ndjeshëm të ardhurat nga shitja e produkteve të saj dhe duke menaxhuar në mënyrë efikase shpenzimet.

Duke u përballur me disa problematika të trashëguara komplekse dhe të pazgjidhura, INSIG sh.a. Shqipëri ka ndërmarrë një numër masash, një pjesë e të cilave të paparashikuara në programin financiar por të domosdoshme për evidentimin, sistemimin dhe konsolidimin e llogarive dhe aseteve të saj sipas kërkesave të ligjit dhe standardeve teknike.



Megjithatë, të dhënat financiare të shoqërisë në përfundim të vitit 2015 dëshmojnë për një numër arritjesh në stabilitetin financiar të saj, duke mbajtur nivelin e duhur të kapitalit, duke zvogëluar kostot operacionale, si edhe duke investuar mjetet e saj në tregun financiar, për të siguruar një kthim optimal.

Duke u kujdesur për respektimin e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe marrëdhëniet kontraktore, gjatë vitit 2015 INSIG, në shumë drejtime, ka bërë përpjekje të mira dhe me impakt pozitiv, duke u ofruar klientëve më shumë besim, siguri dhe fleksibilitet, nëpërmjet produkteve sa më bashkëkohore për klientët e saj ekzistues e të rinj dhe të leverdisshme reciprokisht, si nëpërmjet rrjetit të agjentëve, ashtu edhe nëpërmjet personelit të strukturave që operojnë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen disa të dhëna dhe tregues financiarë për vitin ushtrimor 2015.

Në fushën e Sigurimit të Pasurisë, të ardhurat bruto nga primet (Per Shqiperine) janë në shumën 160,916 mijë Lekë. Ky tregues, është rezultat i një angazhimi të veçantë të INSIG për të përmirësuar veprimtarinë e marrjes në sigurim në këtë fushë të sigurimeve të jo-jetës, si një nga elementët e rëndësishmëm për rritjen e portofolit dhe të fitimit të shoqërisë edhe në të ardhmen.

Fusha e Sigurimit Motorrik, sikurse për të gjitha shoqëritë e tjera që operojnë në treg, edhe për INSIG vijon të mbetet veprimtaria kryesore e cila kontribuon dhe ndikon në arritjen e objektivave të tij, si për shtimin dhe zgjerimin e klientelës, ashtu edhe për rritjen e të ardhurave të shoqërisë. Kjo fushë e veprimtarisë sonë të sigurimeve, përbën rreth 78% për qind të të ardhurave nga primet për sigurimin e jo jetës.

Në fushën e sigurimit **Jetë & Shëndet,** tregu i sigurimeve ka reflektuar problemet dhe vështirësitë e tregut financiar në tërësi. Megjithatë, duke u bazuar në njohuritë e specialisteve tane mbi trendet e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe jetëgjatësisë etj, INSIG sha ka bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u ofruar klientëve zgjidhje të pershtatshme për të siguruar rrezikun e tyre dhe nevojat e menaxhimit të kapitaleve. Në këtë fushë të sigurimeve të ardhurat bruto të INSIG sha Shqiperi për vitin 2015 janë në shumën 98.091 mijë Lekë.

Gjatë vitit ushtrimor 2015 INSIG i ka kushtuar vëmendje të posaçme përmirësimit të profesionalizimit dhe të treguesve që lidhen me ekspertizën, korrektësinë dhe shpejtësinë e trajtimit të rasteve, si edhe pagesën e dëmeve që u janë shkaktuar klientëve dhe personave që i përfitojnë ato sipas kontratës dhe ligjit, duke zbatuar standarde profesionale në trajtimin e tyre, si në dëmet e linjës Jo-Jetë, ashtu dhe në ato të Jetës.

Të dhënat dhe treguesit ekonomikë e financiarë të vitit ushtrimor 2015 shërbejnë si një bazë e mirë lidhur me pritshmëritë nga objektivat e programit financiar të vitit ushtrimor 2016, për garantimin e një shërbimi sa më cilësor dhe tërheqës për klientët, si edhe për të përballuar me profesionalizëm sfidat e shumta me të cilat ballafaqohet tregu i sigurimeve, përfshirë edhe ato që lidhen me arritjen e treguesve financiarë dhe të performancës më të mirë të mundshme në kuadër të procesit të privatizimit të shoqërisë.

EDLIRA DVORANI
DREJTORE E PERGJITHSHME

I. ZHVILLIMET EKONOMIKE NE VEND¹

Ekonomia shqiptare shënoi përmirësim gjatë vitit 2015. Ritmi i rritjes ekonomike u përshpejtua, ndërsa treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik e financiar patën, përgjithësisht, tendenca përmirësimi. Ndonëse në rritje, aktiviteti ekonomik në vend vazhdon të mbetet poshtë nivelit të tij potencial. Kërkesa agregate nuk është e mjaftueshme për të gjeneruar shfrytëzim të plotë të kapaciteteve prodhuese, gjë që reflektohet në nivele ende të ulëta inflacioni.

Në këto rrethana, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka marrë një natyrë më të fortë stimuluese. Kjo politikë ka faktorizuar edhe kahun konsolidues të ndjekur nga politika fiskale, duke krijuar një kombinim të përshtatshëm të politikave ekonomike. Rritja e stimullit monetar është realizuar nëpërmjet reduktimit të mëtejshëm të normës bazë të interesit, nëpërmjet rritjes së injektimit të likuiditetit në sistemin financiar, si dhe nëpërmjet orientimit më të qartë të publikut mbi kursin e ardhshëm të politikës monetare. Këto masa kanë synuar dhe kanë arritur të kontrollojnë primet e rrezikut dhe të ulin kostot e financimit të sektorit real. Megjithatë, përcjellja e plotë e politikës monetare në ekonomi ka vazhduar të frenohet nga pasiguria ende e lartë dhe nga politikat konservatore kredituese të sistemit bankar.

Dobësia ciklike e ekonomisë shqiptare kërkon ndjekjen e politikave të kujdesshme stimuluese. Po ashtu, problemet afatgjata kërkojnë vazhdimin e reformave strukturore, për të përshpejtuar më tej rritjen ekonomike dhe për të rritur qëndrueshmërinë e saj.

Aktiviteti ekonomik vazhdoi ciklin rritës të nisur gjatë vitit të kaluar, punësimi shënoi rritje dhe balancat e brendshme e të jashtme makroekonomike erdhën në përmirësim. Inflacioni mesatar vjetor qëndroi në nivelin 1.9%, duke u rritur me 0.3 pikë përqindjeje nga viti i kaluar. Ndonëse patën luhajtje gjatë vitit, tregjet financiare u karakterizuan nga një ecuri në përmirësimin e likuiditetit, nga tendenca rënëse të normave të interesit dhe nga qëndrueshmëria e kursit të këmbimit.

Në përputhje me strategjinë e konsolidimit fiskal, borxhi publik rezultoi brenda niveleve të parashikuara, ndërsa deficitet buxhetor erdhën në rënie. Po kështu, pozicioni i jashtëm i ekonomisë shqiptare shënoi një përmirësim të lehtë dhe deficitet i llogarisë korrente të vendit u reduktua.

Në këndvështrimin e faktorëve të kërkesës, rritja ekonomike e vitit 2015 ka pasqyruar rritjen e investimeve dhe përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë. Nga ana tjetër, konsumi privat shënoi një tkurrje gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit – kryesisht në përgjigje të pasigurisë – dhe një rikuperim të ngadaltë në tremujorin e tretë. Po ashtu, politika fiskale ishte konsoliduese, e shprehur në reduktimin e stimullit fiskal.

Në këndvështrimin sektorial, rritja ekonomike e vitit 2015 ka pasqyruar kontributin e vazhdueshëm pozitiv të sektorit të shërbimeve, si dhe përmirësimin e aktivitetit në sektorin e ndërtimit. Aktiviteti industrial ka pasur gjithashtu një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike, por ai është karakterizuar nga lëvizje në kahe të kundërta të degëve përbërëse të tij. Së fundi, aktiviteti i sektorit bujqësor ka shënuar rënie.

Rritja ekonomike është shoqëruar me rritjen e punësimit dhe përmirësimin e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese. Megjithatë, ajo ka qenë e pamjaftueshme për të përthithur të gjitha kapacitetet e lira të ekonomisë dhe për të krijuar punëzënie të plotë. Rrjedhimisht, presionet për rritjen e pagave, të kostove të prodhimit dhe të marzheve të fitimit ishin të dobëta. Gjithashtu, ecuria e çmimeve në tregjet botërore, e përmbledhur në nivelet e ulëta të çmimeve bazë dhe të inflacionit në Eurozonë, nuk favorizoi shtimin e presioneve inflacioniste në Shqipëri. Megjithëse në rritje, inflacioni vjetor mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë

II . TREGU I SIGURIMEVE²

Në vitin 2015 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 21.18%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 2,461,841 mijë lekë duke arritur shifrën 14,086,443 mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në 1,097,086 duke shënuar një rritje me 6.36% krahasuar me vitin 2014. Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 13,047,297 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 23.43% krahasuar me vitin 2014.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 983,393 duke shënuar një rritje në masën 6.08% krahasuar me vitin 2014.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 1,026,199 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 0.04% krahasuar me vitin 2014.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 113,683 duke shënuar një rritje në masën 8.87% krahasuar me vitin 2014.

Gjatë vitit 2015, janë paguar gjithsej 3,642,502 mijë lekë dëme ose 28.30% më shumë se gjatë vitit 2014.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2015 është rritur me 2,775 dhe arriti shifrën 29,606 nga të cilat 28,693 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 913 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

III. PARAQITJA E INSIG

Gjatë vitit 2015, INSIG sh.a. vijoi kryerjen e veprimtarisë së saj të shtrirë në tre territore, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Më 31 Dhjetor 2015, INSIG sh.a. kishte 226 punonjës të punësuar në këto tre vende.

Sigurimet e jo-jetës në të tre vendet u përfaqësuan nga produkte të ndryshme, që mbulojnë përgjegjësinë e mbajtësve të mjeteve motorike kundrejt palëve të treta, kasko, zjarrin dhe rreziqet shtesë, vjedhjen, sigurimet e bankave, tipe të ndryshme të përgjegjësisë, marinën dhe mallrat në transport, bujqësinë dhe blegtorinë, etj.

Sigurimet e jetës të ofruara nga Kompania konsistojnë kryesisht në produkte afatshkurtra, si sigurimi i jetës individuale dhe në grup, sigurimi i jetës së nxënësit dhe studentit, sigurimi i jetës së debitorit, sigurimi i kombinuar i jetës, sigurimi i Jetës dhe Shëndet.

Gjatë vitit 2015, INSIG sha ruajti marrëdhënie të qëndrueshme të biznesit me lojtarë të rëndësishëm të tregjeve ndërkombëtare të sigurimeve dhe risigurimeve. INSIG cedoi një pjesë të rreziqeve tek risiguruesit ndërkombëtarë, duke u bazuar në ligjet përkatëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në deklaratën e politikës së veprimtarisë.

Në 24 vite veprimtari, INSIG-u ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet e burimeve njerëzore, nëpërmjet politikave të pranimit dhe programeve të vazhdueshme të trajnimit.

IV. PRONËSIA MBI KOMPANINË

Ne përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar është 1,020,000,000 lekë (nje miliard e njezete milione), i ndarë në 1,700 (njëmijë e shtatëqind) aksione, me vlerë nominale 600,000 (gjashtëqindmije) lekë secili. Gjatë vitit 2015, aksionet e shoqërisë u zotëruan në masën 100 % nga Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financave.

Këshilli Mbikqyrës :

Ervin Mete – Kryetar
Engjëll Agaci – Zëvendës Kryetar
Luneda Sufali – Anëtare
Edlira Luci- Anetare
Spiro Brumbulli – Anëtar

Organizimi i Kompanisë :

Numri mesatar i punonjësve të kompanisë gjatë vitit:

Zyrat qendrore Tiranë : 55
Degët në Shqipëri : 53
Dega INSIG Kosovë : 28
Maqedoni : 90

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.

Degët dhe numri i punonjësve

2015 Nr. Mesatar i punonjesve te INSIG sh.a. QENDER - 55

2015 Nr. Mesatar i punonjesve te INSIG sh.a. DEGET - 54



Shqipëri

Gjendja 31.12.2015		
Nr. rendor	Deget / Agjencite	Nr. i punonjesve
1	BERAT	2
2	DIBER	2
3	DURRES	4
4	ELBASAN	4
5	FIER	4
6	GJIROKASTER	3
7	KAVAJE	2
8	KORCE	3
9	KUKES	2
10	LAÇ	1
11	LEZHE	1
12	LUSHNJE	3
13	POGRADEC	3
14	SARANDE	3
15	SHKODER	3
16	TIRANE	10
17	VLORE	3
Total Dege / Agjenci		53


Kosovë

Gjendja 31.12.2015	
Filijali	Nr. i punonjesve
Qender	21
Prishtine - Mitrovice	2
Ferizaj - gjilan	2
Prizren	1
Peje - Gjakove	2
Totali	28

Maqedoni

Gjendja 31.12.2015	
Filijali	Nr. i punonjesve
Qender	28
Shkup	13
Kumanove	3
Tetove	9
Gostivar	4
Kavadarci	4
Strumica	2
Bitola	3
Kocani	2
Veles	4
Prilep	2
Struga	2
Kicevo	3
Resen	1
Negotino	1
Gjevgjelia	2
Shtipi	2
Diber	2
Ohri	3
Totali	90

ORGANOGRAMA E INSIG



VI. TREGUESIT FINANCIARË

AKTIVITETI SIGURUES


Në vitin 2015 u shkruan 1,617,871,993 lekë prime nga sigurimet e jo-jetës dhe sigurimet e jetës. Shpërndarja territoriale e primeve për vitin 2015 ishte: Shqipëri 52%, Kosovë 20% dhe Maqedoni 28%. Rreth 81% e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 11% nga sigurimet e pronës, 5% nga sigurimi i jetës, dhe 2% nga sigurimet e jetës dhe të shëndetit.

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas territoreve :

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas territoreve

Prime të shkruara bruto	viti 2015	viti 2014
Shqipëri	52%	43%
Kosovë	20%	33%
Maqedoni	28%	24%
Total	100%	100%


Shpërndarja e primeve të shkruara sipas territoreve



Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për Grupin INSIG:

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2015	Ndaj totalit viti 2014
Mjete motorrike	81%	80%
Pasuri	11%	11%
Jete	5%	7%
Shendet	2%	2%
Totali	100%	100%

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit




Shqipëria

Primet e shkruara bruto në vitin 2015 ishin 848,735,357 lekë. Rreth 69% e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 19% nga sigurimet e pronës dhe 10% nga sigurimet e jetës dhe shëndetit.

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2015	Ndaj totalit viti 2014
Mjete motorrike	69%	68%
Pasuri	19%	15%
Jete	10%	16%
Shendet	1%	1%
Totali	100%	100%

Shperndarja e primeve te shkruara bruto sipas linjave te biznesit Shqiperi




Kosova

Primet e shkruara bruto në vitin 2015 ishin 322,132,060 lekë. Rreth 98% e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 2% nga sigurimet e pronës.

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2015	Ndaj totalit viti 2014
Motorrike	98 %	84 %
Pasuria	2 %	15 %
Jeta	-	0 %
Shendeti	-	1 %
Totali	100 %	100 %

Shperndarja e primeve te shkruara bruto sipas linjave te biznesit Kosove




Maqedonia

Primet e shkruara bruto në vitin 2015 ishin 447,004,577 lekë. Rreth 92% e primeve erdhën nga sigurimet motorrike 2% nga sigurimet e pronës dhe 6% nga sigurimet e jetës dhe shëndetit.

Lloji i produktit	Ndaj totalit viti 2015	Ndaj totalit viti 2014
Motorrike	92 %	93 %
Pasuria	2 %	2 %
Jeta	-	0
Shendeti	6%	5 %
Totali	100%	100%

Shperndarja e primeve te shkruara bruto sipas linjave te biznesit Maqedoni

■ viti 2015 ■ viti 2014



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2015 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2015 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 728,841,208 leke.

Deme te paguara ne leke (Grupi)	
2015	728,841,208
2014	604,441,496



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASQYRE E HUMBJEVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE E KONSOLIDUAR

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Prime te shkruara bruto	29	1,617,871,993	1,799,303,465
Ndryshimi neto ne rezerven e primeve te pafituara	20	-109,334,278	32,367,118
Prime të shkruara neto		1,508,537,715	1,831,670,583
Prime te ceduara risiguruesve	30	-119,878,458	-171,330,591
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara për pjesën e risiguruesit		-3,818,742	-24,147,148
Prime të fituara neto		1,384,840,515	1,636,192,844
Të ardhura të tjera nga marrja në sigurim	31	21,144,231	21,598,790
Shpenzimet e demeve dhe te trajtimit te demeve	19	-863,484,107	-825,732,698
Shpenzimet e marrjes ne sigurim	32	-186,299,581	-230,806,339
Shpenzime administrative	33	-660,144,930	-830,149,808
Humbje operative		(303,943,872)	(228,897,212)
Të ardhurat financiare	35	88,477,071	103,142,332
Të ardhura/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	36	21,894,712	36,448,979
Të ardhura financiare neto		110,371,783	139,591,311
(Humbja)/fitimi para tatimit		(193,572,089)	(89,305,901)
	37		
Tatimi mbi fitimin		(17,070,950)	-30,544,812
Humbja e vitit		(210,643,039)	(119,850,713)
Të ardhura përmblendhëse të tjera			
Rezerva përthimi		-17,290,609	572,554
Tatimi i shtyrë nga rezerva e katastrofës			49,245,000
Totali i (humbjes)/të ardhurave përmblendhëse të vitit		(227,933,648)	(70,033,159)

PASQYRE E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL E KONSOLIDUAR

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Kapitali Aksioner	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva për dëmet	Rezerva për katastrofë	Rezerva të tjera	Rezerva e perkthimit	Fitime të mbartura	Totali
Gjëndja më 1 Janar 2014	1,020,000,000	180,626,537	44,677,559	439,201,903	662,672,035	122,883,858	-175,227,500	2,294,834,392
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-119,850,712	-119,850,712
Riklasifikimi i rezervës së				49,245,000	-	-	-	49,245,000
Ndryshime nga kursi i këmbimit	-	-	-	-	-	572,555	-	572,555
Totali i të ardhura përmblendhëse të tjera				49,245,000	-	572,555	-	49,817,555
Totali i fitim/(humbjeve)	-	-	-	49,245,000	-	572,555	-119,850,712	-70,033,157
Totali i fitim/(humbjeve) përmblendhëse (riparaqitur)								
Rritja e rezervave të tjera	-	-	-	-	13,052,847	-	-13,052,847	-
Riklasifikimi i rezervës së				-488,446,903	488,446,903	-	-	-
Dividentë te paguar	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital	-	-	-	-439,201,903	501,499,750	-	-13,052,847	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	1,020,000,000	180,626,537	44,677,559	-	1,164,171,785	123,456,413	-308,131,059	2,224,801,235
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-210,643,039	-210,643,039
Të ardhura përmblendhëse të tjera								
Riklasifikimi i rezervës së	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndryshime nga kursi i këmbimit	-	-	-	-	-	-17,290,609	-	-17,290,609
Totali i të ardhura përmblendhëse të tjera						-17,290,609	-	-17,290,609
Totali i fitim/(humbjeve)	-	-	-	-	-	-	-	-
Rritja e rezervave të tjera	-	-	-	-	1,893,991	-	-1,893,991	-
Riklasifikimi i rezervës së	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividentë te paguar	-	-	-	-	-	-	-	-
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital	-	-	-	-	1,893,991	-	-1,893,991	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	1,020,000,000	180,626,537	44,677,559	-	1,166,065,775	106,165,804	-520,668,089	1,996,867,586

PASQYRE E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TE PARASE

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

Fluksi i parase nga aktivitetet operative	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Humbja pas tatimit	-210,643,039	-119,850,712
Rregullime për:		
Zhvlerësimin	16,811,037	20,125,729
Nxjertja jashtë përdorimit	959,900	12,176,854
Shpenzimet e zhvlerësimit	49,926,761	20,311,251
Ndryshime në detyrimet prej humbjeve dhe shpenzimet nga rregullimet e humbjeve	213,365,043	164,928,667
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	101,077,471	-32,503,450
Ndryshimi në aktivet e risigurimit	-98,305,579	80,423,334
Të ardhura nga interesi	88,477,071	-103,142,333
Ndryshime nga kursi i këmbimit	-17,290,609	-29,032
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative	144,378,057	42,440,308
<i>Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative</i>		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme	-35,628,747	-71,360,268
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	-35,868,779	54,961,173
Ndryshimi në aktive të risiguruar	5,224,707	39,570,185
Ndryshimi në detyrime të risiguruar	-41,269,460	23,137,911
Ndryshimi në aktive të tjera	15,306,119	19,620,088
Ndryshimi në detyrime të tjera	-14,622,627	-3,618,648
Ndryshimi në provigjione të tjera	-6,623,000	-6,359,997
Tatimi mbi fitimin i paguar	-8,553,250	-14,812,033
Flukset monetare të gjeneruara/(te perdorura) nga aktivitetet operative	22,343,020	83,578,719
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje paisjesh dhe aktivesh jo materiale	-3,443,394	-6,591,772
Ndryshim në depozitat me afat	181,927,738	-139,760,328
Blerje e bonove të thesarit	-255,608,580	-422,522,923
Blerje e Investime të mbajtura për tregtim	-1,917,483	-12,841,084
Interesa të marra	-88,477,071	103,142,332
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet investuese	-167,518,789	-478,573,775
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Dividend i paguar		
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese	-	-
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	-145,175,769	-394,995,056
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	297,739,914	692,734,970
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (Shënimi 8)	152,564,145	297,739,914

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më poshtë pëfshihet një informacion përmbledhës nga pasqyrat financiare të audituara

Deklaratë e përputhjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në baze të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe investimeve të mbajtura për tregtim të cilat janë paraqitur me vlerën e drejte.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Keto pasqyra financiare të konsoliduara janë të prezantuara në Leke, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale e Grupit.

Baza e Konsolidimit

Filialet

Filialet janë ato entitete të cilat janë të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë, në mënyrë direkte dhe indirekte, të qeverisë politikën financiare dhe operative të një entiteti si dhe të sigurojë përfitimi nga aktiviteti i tyre. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën kur ky kontroll mbaron.

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Grupi monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Grupi nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politikën dhe procedurën për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përket thimit

të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Grupi ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB ose më të larta dhe të plotësojnë kërkesat e Grupit përsa i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Grupi menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat

Analiza e sensitivitetit

Tabela e mëposhtme detajon sensitivitetin e Grupit ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Në cdo analize sensitiviteti paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, në analizën e sensitivitetit. Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 (në '000 Lek):

Analiza e ndjeshmerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

Shuma	ndikimi	
EUR rritet me 10 % perkundrejt Lekut	Fitim	50,571
EUR bie me 10 % perkundrejt Lekut	Humbje	-50,571
USD rritet me 10 % perkundrejt Lekut	Fitim	6,190
USD bie me 10 % perkundrejt Lekut	Humbje	-6,190
MKD rritet me 10 % perkundrejt Lekut	Fitim	14,713
MKD bie me 10 % perkundrejt Lekut	Humbje	-14,713

Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014:

Shuma	Ndikimi	
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	209,466
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(209,466)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	34,703
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(34,703)
MKD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	75,675
MKD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(75,675)

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 Grupi nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe asnjë instrument të rëndësishëm me norme interesi të luhetshme por ka përqendrim të rëndësishëm të riskut të normave të interesit në depozita me afat dhe bonot e thesarit me maturitet ndërmjet 3 muaj dhe 1 vit.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Grupit sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Grupi do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballëj me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Grupi ka akses në huamarrje më 31 Dhjetor 2015 dhe 2014. Grupi administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Supozime dhe sensitiviteti

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur. Një pamje e përgjithshme e humbjeve nga dëmet dhe raportit të kombinuar për vitin 2015 dhe 2014 jepet më poshtë:

	2015
Raporti i demeve	62%
Raporti i shpenzimeve	48%
Raporti i kombinuar	110%

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara (në ‘000 Lek):

	Impakti	2015
Raporti i demeve		
5 % rritje ne raportin e demeve	Humbje	-43,174
5 % renie ne raportin e demeve	Fitim	43,174
Raporti i shpenzimeve		
5% rritje ne raportin e shpenzimeve	Humbje	-33,007
5% renie ne raportin e shpenzimeve	Fitim	33,007
Raporti i kombinuar		
5 % rritje ne raportin e kombinuar	Humbje	-76,181
5 % renie ne raportin e kombinuar	Fitim	76,181



RAPORT (Përmbledhje)

I Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në INSIG Sha për Vitin 2015.

1. Baza ligjore që rregullon veprimtarinë e AB në INSIG sha.

- Ligji 52/2014 “ Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit “,
- Rregullore e AMF nr. 153/2015 “ “ Për veprimtarinë e njësisë së AB dhe Komitetit të Auditimit në Shoqëritë e Sigurimit”.
- Rregullore “ Për veprimtarinë e AB në INSIG sha” miratuar me vendim të KM nr. 21 date 20.07.2015,
- Rregullore “ Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit” miratuar me vendim të KM nr. 39 date 12.11.2015.

2. Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Gjate vitit 2015 është realizuar përshtatja e veprimtarisë së AB të INSIG sipas kërkesave të ligjit nr. Nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Rregullores së AMF nr. 153 datë 23.12.2014 “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit “, ku me vendimet përkatëse :

- Njësia e AB, varet dhe raporton në Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit.
- Është krijuar dhe funksionon Komiteti i Auditimit. Është miratuar rregullorja e funksionimit të Komitetit të Auditimit (me vendim të KM).
- Me propozim të Komitetit të Auditimit dhe vendim të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura e Departamentit të AB, përbërja e Departamentit dhe Drejtori i Departamentit të AB.
- Është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës rregullorja “Për veprimtarinë e AB në INSIG sha.”

3. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2015.

Plani vjetor 2015 i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në INSIG sha është miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 26 datë 24 Tetor 2014.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm INSIG sha , ka realizuar misionet e Auditimit kundrejt planifikimit në planin vjetor, si më poshtë :

Subjekte të audituara	Plani	Realizuar	Diferenca	Evaduar	Në proces evadimi
Misione auditimi	17	18	+1	18	-

- Njësia e Auditimit të Brendshëm INSIG sha, për vitin 2015 në zbatim të planit të auditimeve miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, Janë realizuar në fakt gjithsej 18 misione auditimi (Të plota 10 misione, të përputhshmërisë 3 misione–financiar 2 misione - Zbatim rekomandimeve 3 misione), pra është realizuar plani i auditimeve dhe evadimi i materialeve të auditimit.

- Ne veprimtarinë e auditimeve për vitin 2015, veçojmë disa misione auditimi si,
- - Auditimi i veprimtarisë së Departamentit Ligjor,
- - Auditimi i veprimtarisë së Departamenteve të Shitjeve (Jo Jete dhe Jete),
- - Auditimi i veprimtarisë së departamentit të Dëmeve,
- - Auditim mbi menaxhimin e aktiveve,
- - Auditimi financiar me tematike vlerësimin e aftësisë paguese, nivelin e aktiveve në mbulim të provigjoneve, vlerësimi i gjendjes financiare, rezultatet teknike të produkteve dhe analiza e disa raporteve monitoruese (sipas rekomandimeve të AMF), etj.
- Auditimet kryesisht janë realizuar duke vlerësuar rrisqet përkatëse të sistemeve dhe fushave të audituara.
- Ne përfundim të çdo misioni auditimi janë nxjerre konkluzione si dhe janë dhënë disa rekomandime për mirë funksionimin e sistemeve dhe realizimin e vetëvlerësimit të rrisqeve dhe performances nga vete departamentet para se ky vlerësim të bëhet nga mbikëqyrësi.

4. Gjetje dhe Konstatimet të klasifikuara sipas sistemeve dhe fushave të audituara janë :

4.1 Nga vlerësimi i Sistemit dhe risqeve të Marrjes në sigurim (Produktet JO Jete dhe Jete), është konstatuar se :

- ka një bazë rregullative të mjaftueshme si, kushtet e përgjithshme të marrjes në sigurim, sistemi tarifor, procedurat e administrimit, mënyra e shitjeve;
- produktet shiten dhe administrohen në programin e shitjes, kjo realizon saktësi në lëshimin e policave, zbatimin e sistemit tarifor, parandalimin e risqeve të sigurimit, etj.
- territori është mbuluar me agjente shitjeje të licensuar nga AMF në të gjithë degët e INSIG sha (me përjashtim të Zyrës së Përfaqësimit Kukës) dhe të regjistruar në organet tatimore duke vepruar si persona fizik, me përjashtim të 3 prej agjenteve të Degës Kavaje, kjo ka ndikuar pozitivisht në formalizimin e shitjeve dhe mbrojen nga rrisqet rregullatore.
- Në përgjithësi praktikën e marrjes në sigurim janë të plotësuar me dokumentacionin e kërkuar. Por në sigurimin e Pergjegjesisë BBB dhe CIS & CIT, duhet bërë një analizë paraprake me e plotë dhe e detajuar e riskut në bazë të historikut të ngjarjeve të ndodhura, të bëhet verifikim i sigurimit të Kontrates së Shoqërisë së Ruatjes Fizike të Bankes, duke përfshirë edhe në kushtet e marrjes në sigurim, etj.

4.2 Nga vlerësimi i risqeve dhe sistemi i vlerësimit dhe trajtimit të dëmeve, është konstatuar,

- Në përgjithësi zbatohen procedurat dhe plotësimi i dokumentacionit për trajtimin dhe pagesat e dëmeve,
- në nëntor 2015 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar rregullore për trajtimin e dëmeve,
- në disa raste vërtetimi miqësor i ngjarjes dhe njoftimi i rastit të sigurimit nuk janë plotësuar sipas formatit të miratuar,
- për disa praktika dëmsh ku janë konstatuar elementë të pa qartë të ngjarjes së sigurimit duhet të ishte kryer investigim paraprak,
- veprimtaria e trajtimit të dëmeve të Kartanit Jeshil nga kompanitë trajtuese të huaja duhet të monitorohet në mënyrë më të plotë nga Departamenti i Dëmeve, sidomos në rastet e mungesës së një Raporti Policie, mungesës së fotove të mjetit shkaktar dhe mungesës së deklaratës së shkaktarit të dëmit.

5.3 Nga auditimi i sistemit te Menaxhimi i rrezikut, vlerësimi i situatës financiare, provigjoneve , etj. është konstatuar;

-Kapitali i llogaritur dhe aftësia paguese me 30.09.2015, është i mjaftueshëm sipas kërkesave ligjore,

- provigjonet teknike të llogaritura nga aktuari i kompanisë me 31.12.2014, janë miratuar me vendim të bordit të AMF nr.1 datë 20.03.2015 duke u shprehur edhe për mjaftueshmerinë e tyre

- niveli i aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike eshte 133% ,

- niveli i kapitalit(aftësisë paguese)për vitin 2014 është 147% ,

- rezultati teknik (rezultati financiar nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i sigurimit), sipas produkteve rezulton së në vitin 2014 rezulton me humbje , kryesisht ne MTPL, Kartoni Jeshil, Aviacioni dhe Pasuria (BBB).

5.4 Nga vlerësimi i sistemit te kontrollit Brendshëm, është konstatuar,

- Gjate vitit 2015, ne zbatim edhe te përshtatjes se veprimtarisë se shoqërisë me ligjin e ri te sigurimeve 52/2014 dhe rregulloret e AMF, janë miratuar 12 rregullore nga Këshilli Mbikëqyrës qe kane te bëjnë me funksionimin e sistemit te kontrollit te brendshëm, menaxhimin e rrisqeve, trajtimin e dëmeve, menaxhimin e shpenzimeve dhe pagesave, etj.

- Kjo ka ndikuar ne efektivitetit të veprimtarisë së strukturave përkatëse për monitorimin e veprimtarisë dhe te risqeve në përputhje me legjislacionin në fuqi; në rregulloret e miratuara por dhe ne zbatimin praktik ne përgjithësi ka ndarje funksionesh për verifikimin, kontrollin, autorizimin e operacioneve në marrjen në sigurim, te trajtimit te dëmeve, te kryerjes se pagesave, etj.

Rekomandimet e dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2015.

- Në auditimet e kryera gjatë vitit 2015, duke vlerësuar edhe specifikat e veçanta që ka çdo sistem i audituar, i është kushtuar rëndësi dhënies së rekomandimeve të harmonizuara edhe me mendimin e specialistëve të fushave përkatëse, qe kane te bëjnë me përmirësimin e sistemeve dhe fushave përkatëse dhe ne minimizimin dhe parandalimin e risqeve.

Auditim e të kryera	Rekomandime		Në proces ndjekje dhe zbatimi	Masa disiplinor e të dhëna për punonjësi t	Gjetje me efekte financiare	
	Të dhëna	Te zbatuara			Nr.	000/ lekë
18	168	135	33	5	9	1,046.30

Për 18 auditimet e kryera, janë dhënë gjithsej 168 rekomandime për zbatim, janë zbatuar 135 dhe janë në proces zbatimi 33 rekomandime.

Te gjitha rekomandimet janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, sipas raporteve përkatëse të paraqitura nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Raporti “Mbi veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm” për vitin 2015 është miratuar nga Komiteti i Auditimit me vendim nr. 01 datë 9 mars 2016 dhe nga Këshilli Mbikëqyrës i INSIG sh.a me vendim nr.04 datë 21 prill 2016.

Raporti i veprimtarisë së AB, sipas kërkesave ligjore është depozituar brenda afatit ligjor edhe në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

